



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 08

Prishtinë, më 19.3.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Valdete Bajrami, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Slavko Simiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit- UNICEF.

Të ftuar: Mustafë Ahmeti dhe Bojamir Hoxha, përfaqësues të punëtorëve të hotelit “Grand” dhe Avni Jashari e Shefik Kurteshi, përfaqësues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Pjesëmarrës të tjerë: Edona Tolaj- YIHR; Selvete Gërzhaliu- GDNJD; Lejla Selimi- OSBE; Elvine Sefiu-Tribuna Chanel; Florina Merovci- ZPRK; Behxhet Shala- KMDLNJ; Visar Bivolaku- EUO/EUSR; Sehida Miftari-OSBE; Basri Berisha-AP; Uke Gashi-ZPRK; Mejreme Tahirukaj, RTK- Radio Kosova; Mimoza Kqiku-BIRN; Burim Zariqi- RTV21; Drilon Asllani-Radio Dukagjini, Qëndrim Imeri-Infodirekt TV; Leotrim Berisha-Tribuna Chanel; Deli Sadikaj-Kosovapress; Alban Muhaxheri- gazeta “Zëri”; Elita Lushi-Rrokum TV; Sakibe Jashari- Ambasada e Zvicrës dhe Arta Xhylani-praktikante Kuvendi i Kosoves.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 07;
3. Shqyrtimi i ankesave lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit;
4. Shqyrtimi i peticionit të punëtorëve të hotelit “Grand” në Prishtinë (të ftuar për këtë pikë të rendit të ditës janë: përfaqësuesit e peticionit dhe të AKP-së);
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nr. 07

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 9.3.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i ankesave lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve për Avokatin e Popullit

Kryetarja, duke dashur që të jetë më precize lidhur me rekomandimin, iu referua procesverbalit të mbledhjes, në të cilën është nxjerrë rekomandimi. Pasi e lexoi rekomandimin e nxjerrë në mbledhjen e Komisionit, të mbajtur më 9 mars 2015, ajo theksoi se shkresa i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit, dhe në këtë rast, Kryetari i Kuvendit e ka kthyer shkresën sërish në Komision, me qëllim që Komisioni të mund të bëjë shqyrtimin e ankesave, të cilat kanë arritur lidhur me këtë çështje. Sa i përket ankesave, ajo tha se ankesat i kanë marrë edhe anëtarët e tjerë të Komisionit. Ankesa e parë ishte parashtruar nga aplikanti, z. Agim Vatovci, i cili me ankesë i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit, me qëllim të ankesës në rastin e përzgjedhjes së dy kandidatëve nga partitë politike siç ka pretenduar ai, më konkretisht për znj. Suzana Novoberdaliu dhe z. Mazllum Baraliu, të cilët kanë qenë në lista të partive politike në zgjedhjet qendrore. Lidhur me këtë, ajo theksoi se ligji e specifikon këtë çështje, sipas të cilit kandidatët nuk duhet të ushtrojnë funksion politik në parti dhe lidhur me këtë, ajo tha se këta kandidatë, realisht, nuk ushtrojnë funksione politike në parti dhe ishte e mendimit që ankesa është e pabazuar.

Teuta Haxhiu, theksoi se ajo ka munguar në mbledhjen e fundit, por në parim i mbështet të dyja ankesat. Ajo e përmendi që ka qenë shqetësim i saj edhe para se të ndodhë rasti se

si do të veprohet në rast se ndodh që kandidatët të jenë me pikë të njëjta dhe nga përvojat që i ka pasur lidhur me rastin e KPM-së, ka thënë se në rast se vjen deri tek pikët e njëjta të kandidatëve, atëherë ata duhet që të futen edhe një herë në poentim, jo të intervistohen sërish, sepse një herë janë intervistuar, por vetëm të poentohen sërish. Ajo tha që ka kërkuar nga Komisioni që ta kenë një shkresë nga Zyra Ligjore, në mënyrë që ta kenë të qartë, bazë e cila ka mundësuar dërgimin e 4 kandidatëve. Ajo ishte e mendimit që dy kandidatet e fundit, të hyjnë sërish në poentim, në mënyrë që të zgjidhet njëra prej tyre dhe Kuvendit t'i dërgohen 3 kandidatë, sepse ajo nuk u pajtua me rekomandimin, sipas të cilit, Kuvendit do t'i dërgohen 4 kandidatë. Edhe sa i përket ankesës së dytë, ajo u pajtua, duke theksuar se përvoja që ka pasur me raste në të kaluarën nga KPM-ja, drejtori i të cilës është zgjedhur dhe i cili ka qenë anëtar i Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe e ka mashtuar Komisionin, dhe vetëm pas një viti, përmes mediave, është vërejtur se ai është anëtar i Këshillit. Lidhur me këtë, ajo e përmendi se anëtarët e Komisionit, njëzëri, janë pajtuar që të hartohet një shkresë në të cilën kandidatët do të deklarohen se nuk ushtrojnë funksion politik në asnjë parti politike, duke mos e precizuar kohën pasi që ligji nuk e saktëson kohën se në çfarë kohe kandidati duhet të mos jetë aktiv në ndonjë parti politike. Në fund, ajo e përsëriti qëndrimin e saj që pajtohet me të dyja ankesat dhe kërkoi nga Komisioni që të shqyrtohet mundësia e futjes në ripointim të dy kandidateve, të cilat e kanë numrin e njëjtë të votave ose që Komisioni ta nxjerrë një shkresë e cila do të bazohet në sqarimin që do të vijë nga Zyra Ligjore e Kuvendit, lidhur me këtë çështje.

Kryetarja, lidhur me këtë theksoi se janë konsumuar këto mundësi, pasi që ata kanë kontaktuar me Zyrën Ligjore dhe kanë kërkuar që ata të jenë prezent në takim, mirëpo nuk i dinë arsyet e mosardhjes së përfaqësuesve të Zyrës Ligjore të Kuvendit.

Salihe Mustafa, theksoi se ankesa është e drejtë e secilit që pretendon në të drejtat e tij dhe Komisioni është i obliguar që t'i shqyrtojë ato ankesa. Lidhur me këtë, ajo tha se ata kanë punuar në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe Rregullores për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij. Lidhur me çështjen që ka të bëjë me aktivitetin politik të kandidatëve, ajo përmendi se unanimisht janë pajtuar që kandidatët të nënshkruajnë atë ditë një shkresë, në bazë të së cilës deklarojnë se nuk janë aktivë në parti politike. Ajo tha se e di fare mirë që disa nga kandidatët kanë qenë në lista të partive politike në zgjedhjet qendrore, mirëpo ligji nuk e saktësohen kohën brenda të cilës ata duhet të mos jenë aktivë, dhe për këtë shkak, ata kanë vendosur që ta hartojnë një deklaratë të cilën e kanë nënshkruar të gjithë kandidatët se nuk janë aktivë dhe nuk i përkasin asnjë partie politike në vend. Në rastin e dytë, që ka të bëjë me dërgimin e 4 kandidatëve për seancë, ajo e përmendi se, unanimisht, Paneli ka vendosur për një veprim të tillë, përveç anëtares e cila për arsyet e theksuara paraprakisht, ajo është larguar pas procedurës së poentimit të kandidatëve. Po ashtu, pas konsultimit me Zyrën Ligjore, janë lejuar që Kuvendit t'ia përcjellin 4 kandidatë, për shkak se çfarëdo veprimi që do të merrnin, qoftë klasifikim përmes emrit apo mbiemrit, do të bëhej diskriminim ndaj tyre dhe për këtë arsye ata kanë vendosur që t'i dërgojnë 4 kandidatë.

Valdete Bajrami, duke u ndërlidhur me ankesën e z. Agim Vatovci, ritheksoi se Komisioni e ka përpiluar shkresën në të cilën janë deklaruar të gjithë kandidatët se nuk i

përkasin asnjë partie politike. Lidhur me këtë, ajo tha se Komisioni nuk mund që ta luajë rolin e hetuesit, në mënyrë që të vërtetojë se a janë ata realisht jashtë partive politike apo jo. Sa i përket numrit të kandidatëve, të cilët do t'i përcillen Kuvendit, ajo tha se ata kanë tentuar që të mos bëjnë diskriminim në asnjë formë dhe për këtë shkak kanë vendosur unanimisht që Kuvendit t'i përcillet lista prej 4 anëtarësh dhe pastaj Kuvendi të vendosë se kush do të bëhet Avokat i Popullit.

Kryetarja, duke u ndërlidhur me deklarin e anëtares së Komisionit, znj Teuta Haxhiu, theksoi se për atë rast janë kritere të tjera të përcaktuara me ligje të tjera, të cilat e precizojnë saktësisht kohën brenda të cilës ata nuk mund të jenë ushtrues të funksioneve politike nëpër partitë politike, kurse Ligji për Avokatin e Popullit nuk e precizon. Në këtë mënyrë dhe për këtë shkak, ata kanë vendosur që përmes deklaratës që e kanë nënshkruar të gjithë kandidatët, të marrin konfirmimin e tyre se nuk i përkasin asnjë partie politike. Ajo, po ashtu, e lexoi edhe shkresën e dytë e cila ishte shkresa që është bërë nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, drejtuar Kryesisë së Kuvendit dhe Komisionit për të Drejtat e Njeriut, që përmbante çështjen e dërgimit të 4 kandidatëve në vend 3, siç e përcakton ligji. Duke u ndërlidhur me këtë, kryetarja theksoi se duke tentuar që të mos e lëndojnë esencën e vlerësimit që është bërë nga Paneli intervistues dhe duke mos dashur që të bëjnë diskriminim në asnjë formë, kanë vendosur që Kuvendit t'ia përcjellin listën me 4 kandidatë.

Teuta Haxhiu, duke insistuar në dërgimin e tre kandidatëve për në Kuvend, theksoi se edhe përvoja nga legjislatura e kaluar ka treguar se ka vështirësi në përzgjedhjen e pozitive të tilla, dhe sa më shumë kandidatë që të ketë për këtë pozitë, aq më shumë do të vështirësohet mundësia e zgjedhjes së Avokatit të Popullit. Po ashtu, u ndërlidh edhe me një çështje tjetër që kishte të bënte me shqyrtimin e ankesave, sipas mendimit të saj, nuk është mirë që Komisioni t'i shqyrtojë këto ankesa, sepse ata kanë bërë intervistimin e këtyre kandidatëve dhe do të kishte qenë mirë që dikush tjetër të bënte shqyrtimin e ankesave.

Mytaher Haskuka, duke u ndërlidhur me ankesën e dytë e cila ka të bëjë me aktivitetin politik të kandidatëve, theksoi se ligji shumë qartë e thekson se kandidatët nuk duhet të jenë aktivë në parti politike. Ai tha se ligji e rregullon të tashmen që d.m.th. se kandidati nuk duhet të jetë aktiv tani, duke mos e specifikuar kohën e kaluar. Ai, po ashtu, theksoi se kandidatët e kanë nënshkruar deklaratën dhe në këtë rast nuk ka asgjë problematike. Sa i përket ankesës së dytë, ai tha se ata janë pajtuar, me qëllim që të shmangin çfarëdo forme të diskriminimit si Komision dhe kanë vendosur që Kuvendit t'i dërgohen 4 kandidatë, sepse siç tha ai, do të bëhet diskriminim, nëse do të eliminonte njërin nga kandidatët që i kanë pikët e barabarta, qoftë me emër apo me mbiemër.

Kryetarja, pasi i dëgjoi diskutimet e të gjithë anëtarëve të Komisioni, theksoi se si përfundim, Komisioni qëndron prapa rekomandimit të vet, sipas të cilit Kuvendit do t'i dërgohen 4 kandidatë për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Teuta Haxhiu, duke e ripërsëritur qëndrimin e saj kundër dërgimit të 4 kandidatëve në Kuvend, kërkoi nga Komisioni që të kërkojnë një përgjigje me shkrim nga Zyra Ligjore, që ata të sqarojnë se si të veprohet në këtë rast.

Kryetarja, ritheksoi se ky rekomandim i është përcjellë njëherë Kryesisë së Kuvendit dhe nuk është e nevojshme që të kërkohet tani interpretim nga Zyra Ligjore, ndërsa nëse këtë e kërkon Kryesia nga Zyra Ligjore, atëherë ata le t'ia përcjellin atë shkresë Kryesisë, sepse në Komision, kjo çështje është konsumuar dhe i ftoi anëtarët që sërish me votim të deklarohen se a pajtohen ta dërgojnë rekomandimin si të tillë në Kuvend.

Salihe Mustafa, duke u ndërlidhur me rekomandimin, tha se nuk është e nevojshme të kërkohet sqarim nga Zyra Ligjore, sepse ky ka qenë vendim unanimit i vendosur nga Komisioni dhe nuk është e arsyeshme që tani të kërkohet një shkresë e tillë.

Pas këtyre diskutimeve, anëtarët e Komisionit sërish me 7 vota për dhe 1 kundër, vendosën që Kuvendit t'i përcillet rekomandimi, i cili përmban listën prej 4 kandidatëve për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit.

3. Peticioni i punëtorëve të hotelit “Grand”

Kryetarja, duke u bazuar në të drejtën kushtetuese të secilit për paraqitje të ankesave, theksoi se do të shqyrtohet peticioni i punëtorëve të Grandit, dhe lidhur me këtë, kanë ftuar përfaqësuesit e punëtorëve që kanë paraqitur peticionin, si dhe përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në mënyrë që dëgjohen deklaratimet e të dyja palëve lidhur me këtë çështje për të cilën punëtorët kanë paraqitur peticion. Para se t'u jepej fjala palëve përfaqësuese, kryetarja e lexoi në tërësi peticionin, të cilin e kanë paraqitur punëtorët e Grandit. Gjatë leximit të peticionit, u veçuan këto pika me rëndësi, të cilat i kanë kërkuar ata: 1. Nënshkrimi i kontratave për shërbime për të gjithë punëtorët e Grandit dhe të zhblllokohet situata e krijuar në këtë institucion; 2. Mbetja në punë e të gjithë punëtorëve të Grand Hotelit me vetëfinancim, deri në shitje të hotelit “Grand” 3. Propozohet të punohet siç është punuar prej datës 6. 8. 2012, deri më 2. 2. 2015, me ç'rast kanë pasur një afarizëm të mirë duke i përmbledhur obligimet komunale, si dhe rrogat e punëtorëve; 4. Mos të pengohet aktiviteti sindikal nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Pas leximit të kësaj shkrese, ajo tha se, si Komision, ata do të tentojnë të arrijnë deri te një zgjidhje e cila, në këtë rast, nuk i dëmton interesat e asnjërës palë.

Mustafë Ahmeti, në cilësinë e kryetarit të sindikatës së hotelit “Grand” dhe zyrtar ligjor në hotelin “Grand”, i lexoi sërish kërkesat e punëtorëve të hotelit “Grand”, të cilët kërkojnë që të merren veprime konkrete për këtë rast. Ai tha se pas shqyrtimit të gjitha mjeteve të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre si punëtorë, i janë drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut, me këtë peticion. Gjatë leximit të peticionit, ai përmendi se duke marrë parasysh shkaku që AKP-ja nuk e ka bordin e kompletuar, Departamenti i Falimentimit ka vënë barrierë, e cila e çon në shkatërrim këtë ndërmarrje, duke i larguar nga puna punëtorët pa asnjë bazë ligjore, me

qëllim që objektet e hotelit “Grand” t’i lirojnë me qira, dhe në këtë mënyrë, të përfitojnë nga qiratë e dyfishta. Në vazhdim, ai i përmendi rastet e qirave të dyfishta dhe furnizimit nga ndërmarrjet e familjarëve të tyre, raste këto që po e çojnë në shkatërrim ndërmarrjen e hotelit “Grand”. Ai tha se për këto keqpërdorime e kanë njoftuar rregullisht ish-menaxhmentin e AKP-së, por asnjëherë nuk janë marrë vërejtje. Po ashtu, ai e përmendi se ndaj zyrtarëve të lartcekur është ngritur një kallëzim penal, në bazë të provave që ata i posedojnë. Ai kërkoi nga Komisioni që të dalë me një rezolutë e cila do të miratohej nga Kuvendi, me qëllim të parandalimit shkatërrimin e kësaj ndërmarrjeje nga politikat degraduese të AKP-së, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje, si dhe vetë objektit të kësaj ndërmarrjeje. Në vazhdim, përmendi edhe kërkesat e përmendura më lart nga kryetarja e Komisionit, të cilat kishin të bënin me: 1. Nënshkrimin e kontratave për të gjithë punëtorët deri në shtije të hotelit “Grand”, sepse punëtorët janë pa kontrata dhe pa paga; 2. Të shkarkohet zyrtari për rastin e hotelit “Grand”, Rafet Ferizi, pasi që sipas tyre ka konflikt interesi dhe ka qenë keqpërdorues ku edhe AKP-ja ka qenë e informuar, para se ai të emërohet në këtë pozitë; 3. Të merren masa për zhbllokimin e financave, në mënyrë që të zgjidhet problemi i pagave të punëtorëve, të cilët edhe pas 54 ditëve nuk kanë marrë paga dhe nuk dihet kur do të paguhen ato; 4. Të mos pengohet aktiviteti sindikal në hotelin “Grand”, sepse kjo është e drejtë e përcaktuar me legjislacion vendor dhe ndërkombëtar.

Avni Jashari, në cilësinë e ushtruesit të detyrës së zëvendës drejtorit të AKP-së, duke u ndërlidhur me peticionin e paraqitur nga punëtorët e hotelit “Grand”, theksoi se në bazë të rregullave, në datën e vendosjes së ndërmarrjes në likuidim, kontratat e punëtorëve ndërpriten automatikisht. Duke iu referuar nenit 9, ai tha se të gjitha të drejtat menaxhuese të ndërmarrjes, ndërpriten automatikisht në momentin e vendosjes së ndërmarrjes në likuidim. Sipas tij, kjo ka ndodhur në shkurt, në bazë të vendimit të marrë më herët, në bazë të të cilit hoteli “Grand” është vënë në likuidim, edhe pse zbatimi i këtij vendimi është shtyrë për gjashtë muaj, për shkak se bordi i AKP-së ka qenë i pakompletuar. Duke u ndërlidhur me çështjen e pagesave, ai tha se pas analizave financiare që janë bërë, kanë ardhur në përfundim se, në rast se vazhdohet me dhënien e pagave ashtu siç ka qenë pas periudhës njëvjeçare, hoteli “Grand” do të ishte minus 144000 euro, dhe duke marrë parasysh këtë, ata kanë vendosur që punëtorët të mbahen në punë në periudhe tremujore. Lidhur me akuzat e bëra nga punëtorët për keqpërdorime, ai tha se kushdo që ka dëshmi për çfarëdo keqpërdorimi, le të drejtohen tek organet kompetente, në mënyrë që të sqarohen këto çështje dhe të merren veprime adekuate. Sa i përket organizimit sindikal, ai tha se në bazë të ligjit, në rastin kur ndërmarrja vendoset në likuidim, organizimi sindikal, nuk është i mundshëm në anën formale. Në vazhdim, tha se nuk e konsiderojnë se ka shkelje të të drejtave të njeriut, respektivisht të punëtorëve, sa i përket datës së vendosjes së ndërmarrjes në likuidim, për shkak se përveç Grand-it, edhe 461 ndërmarrje të tjera janë në likuidim. Lidhur me çështjen e pagave, ai tha se me kërkesën e tyre, punëtorëve u janë paguar edhe pagat e muajit janar 2015, d.m.th. para se ndërmarrja të vendosej në likuidim, ndërsa pasi që ndërmarrja të vendoset në likuidim, nuk kanë obligim për ata, sepse kontratat e tyre shkëputen automatikisht.

Shefik Kurteshi, në këtë fazë kalimtare që jemi, pa bord dhe pa udhëheqje, po mundohemi t'i kalojmë këto situata me një zgjidhje të përkohshme. Unë i inkurajoj përfaqësuesit e hotelit "Grand" për petitionin, është Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme dhe për gjithçka që konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, t'i ndjekin rrugët institucionale.

Kryetarja, tha se është dashur që t'ju dëgjojmë të dy palëve, që të kemi informacion të mjaftueshëm për të parë se çka është e nevojshme të ndërmerret, pra cili është obligim i yni dhe obligim i të tjerëve. Si Komision, do të kujdesemi për të respektuar të drejtën.

Mustafë Ahmeti, tha se i kupton zyrtarët e AKP-së që nuk ka kompetencë edhe aq të fuqishme që të marrin vendime të tilla. Sipas tij, ka vend që ndaj zyrtarëve në fjalë, keqpërdorues, për të marrë masa ndaj tyre, që mos me t'ju vijë situata për të vazhduar me keqpërdorime. Në vitin 2013 kanë filluar keqpërdorimet dhe janë duke vazhduar edhe tani me likuidim, sepse nuk ka transparencë.

Teuta Haxhiu, tha se deri sa nuk jeni komplet si bord, sa keni të drejtë ju si bord për marrjen e vendimeve të tilla, dhe kush i merr ato vendime, derisa vazhdimisht thirrni në atë se nuk keni kuorum për të marrë vendime për të bërë pagesën e punëtorëve të ish-fabrikës së tubave dhe shumë vendime të tjera, në anën tjetër merrni vendime për të degraduar ndërmarrjen në fjalë, sikur ka ndodhur të degradohen edhe shumë ndërmarrje. Përfundimisht, nuk jeni kompetentë për të marrë vendime, mendoj që këtë shqetësim duhet ngritur në Kuvend dhe të gjitha vendimet e AKP-së, lidhur me këtë, janë të kundërligjshme, dhe përderisa nuk është bërë shitja e Grand-it, ju si agjenci nuk keni të drejtë për të marrë asnjë vendim.

Mytaher Haskuka, është e drejtë e punëtorëve të paraqesin petitionin me kërkesat e tyre. Nuk është keq që të procedohet në seancë dhe të kërkojmë diskutim për këto kërkesa në Kuvendin e Kosovës dhe të shikohet se çfarë të ndërmerret, sepse janë interesat e 92 personave, pra bëhet fjalë për 92 familje.

Valdete Bajrami, ne si Komision duhet të kërkojmë nga AKP-ja që ta shikojmë vendimin dhe procesverbalin kur është marrë vendimi për Grandin, kush ka votuar për kush kundër, a ka pasur kuorum, sepse dihet që bordi është i pakompletuar. Pra, këto materiale neve na duhen për ta shqyrtuar drejt dhe ta ngremë këtë çështje në Kuvend.

Salihe Mustafa, tha se morëm shumë informacione rreth këtij problemi, pra me çfarë vendimi keni vazhduar punën prej 6.8.2012 deri më 2.2.2015, si keni mundur të vazhdoni, në çfarë mënyre. Ju dëgjuam se nuk ka mjete, por si keni mundur atëherë të vazhdoni punën dhe pse nuk mundeni tash, kush i ka caktuar përfaqësuesit e punëtorëve?

Avni Jashari, vendimin për vendosjen e ndërmarrjes hotel "Grand" në likuidim e ka marrë Bordi i drejtorëve në mbledhjen gushtit 2014, në përbërje të plotë. Hoteli "Grand" është shitur një herë në vitin 2005, janë tërhequr aksionet në vitin 2012. Sipas ligjit, tani llogaritet ndërmarrje në likuidim dhe kjo do të shitet kur kompletohet Bordi i drejtorëve.

Agjencia edhe pse ka bërë planin për vitin 2015 dhe ka bërë planin e shitjeve, nuk i ka vendosur ende në shpallje në tender shitjen e ndërmarrjeve shoqërore, sepse duhet të kompletohet Bordi i drejtorëve.

Teuta Haxhiu, këtë vendim të çështjes së analizës financiare që ju e quajtet thellësisht e rënë dhe argumentet e anës tjetër që janë diametralisht të kundërta, për një periudhë kohore njëmuajore apo dymujore, për mua është një shqetësim.

Mustafë Ahmeti, është e mundur që në atë periudhë rreth 60 mijë euro kanë mbetur borxhe të pambledhura, pra që neve na kanë pasur borxhe. Ne në atë periudhë, i kemi paguar borxhet, përveç një pjesë për ngrohje, pra një pjesë që nuk kam kontroll se a është paguar apo jo, kurse kemi fakte se 54 mijë euro janë mjete të përmbaruesi privat që na ka borxh dhe 12 mijë euro janë mjete të pambledhura nga qiraxhinjtë. Pra, nuk ka vend për t'u thirrur në atë se nuk ka pasur mjete.

Kryetarja falënderoi palët që dhanë këto informata dhe tha se, ne si Komision, e kemi formuar një grup punues që do të merret më drejtpërdrejt me këtë problem dhe do të arrijmë në një zgjidhje për këtë peticion.

6. Të ndryshme

Komisioni vendosi që për peticionin për zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit, në mbledhjen e radhës, të ftohen përfaqësuesit e peticionit dhe përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur.

Gjithashtu, Komisioni për shqyrtimin e udhëzuesit për peticione vendosi që të mbahet një punëtori dyditore, mbështetur nga OSBE-ja, në hotel "Magna Austria" në Rugovë, më 31 mars dhe 1 prill 2015. Lidhur me këtë, fillimisht u formua edhe një grup punues, në përbërje: Mexhide Mjaku-Topalli, Teuta Haxhiu dhe Hetem Arifi.

Komisioni vendosi që mbledhjen e radhës ta mbajë më 25 mars 2015, në orën 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi

